



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVES - VLADE KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH	
Shkronja Org. Org. Unit	02
Shkronja Proje. Proj. No	05-4791
Forma Receve Electronic	-4-
Data Date	09/08/2023
Prishtinë / a	


Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva


PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

MENAXHIMI I MBETURINAVE MEDICINALE TË MJETEVE TË MPREHTA

VERSIONI: [1.0]
DATA E APROVIMIT: [07/08/2023]
AUTOR: [MSh]
NR. I HAPAVE: [V]
NR. I NËNHAPAVE: [XXII]

APROVUAR:

 Dr. Naim Bardiqi,
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



<p>QËLLIMI</p>	<p>QËLLIMI I PROCEDURËS STANDARDE OPERATIVE (PSO) ËSHTË DEFINIMI I HAPAVE KONKRET TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE MEDICINALE TË MJETEVE TË MPREHTA NË INSTITUCIONE SHËNDETËSORE DHE INSTITUCIONE TJERA KU OFROHEN SHËRBIME SHËNDETËSORE, ME QËLLIM TË MBROJTJES SË SHËNDETIT TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR, SHËNDETIT PUBLIK DHE TË MJEDISIT.</p> <p>KJO PSO ZBATOHET NË TË GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE DHE PRIVATE TË NIVELIT PARËSOR, DYTËSOR DHE TRETËSOR, SI DHE INSTITUCIONET E TJERA TË CILAT OFROJNË SHËRBIME SHËNDETËSORE.</p>
<p>NDËRLIDHJA ME AKTET</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. LIGJI NR 04/L125 PËR SHËNDETËSI; 2. LIGJI NR. 04/L-060 PËR MBETURINA; 3. LIGJI NR 04/L190 PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE; 4. UA MPMH NR 10/2015 PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE NGA PRODUKTET MEDICINALE.
<p>LISTA E SHKURTESAVE & DEFINICIONET</p>	<p>MMPHI – MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS;</p> <p>MSH - MINISTRIA E SHËNDETËSISË;</p> <p>PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE;</p> <p>QKUK – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS;</p> <p>SP – SPITALI I PËRGJITHSHËM;</p> <p>UA - UDHËZIM ADMINISTRATIV;</p> <p>MJETE TË MPREHTA – MJETE TË MPREHTA TË PËRDORURA OSE TË PAPËRDORURA (PSH. GJILPËRA NËNLËKURORE, INTRAVENOZE OSE TË TJERA, VETË-DEAKTIVIZUESE, SHIRINGA ME GJILPËRA TË LIDHURA, BISTURI, SHARRA, PIPETA, THIKA, TEHE, XHAMA TË THYER)¹.</p> <p>KUTIA E SIGURISË - KUTIA E SIGURISË PËR MJETE TË MPREHTA (SAFETY BOX) PËRDORET PËR TË HUDHUR GJILPËRA DHE MJETE TË TJERA TË MPREHTA TË PËRDORURA, DHE ZAKONISHT ËSHTË NGA KARTONI APO PLASTIKA E FORTË.</p>

¹ *Safe management of wastes from health-care activities Second edition Edited by Yves Chartier, Jorge Emmanuel, Ute Pieper, Annette Prüss, Philip Rushbrook, Ruth Stringer, William Townend, Susan Wilburn and Raki Zghond, World Health Organization 2014*

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Hedhja e Gjilpërave të Përdorura	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pas përdorimit <i>ASNJËHERË</i> mos rivendosni kapakun e gjilpërës; 2. Gjithmonë përdorni dorëza; 3. Nëse ju bie gjilpëra, asnjëherë mos e kapni prapë me dorë. Përdorni pincetë ose mjet tjetër adekuat për t'a hedhur atë në kutinë e sigurisë/safety box; 4. Pas përdorimit asnjëherë mos leni gjilpërën mbi tavolinën e punës apo vendin afër administrimit, hidhni menjëherë atë në kutinë e sigurisë; 5. Hidhni gjilpërën e përdorur në kutinë e sigurisë; 6. Gjilpëra e përdorur asnjëherë nuk duhet të hedhet në kontejnerin e mbeturinave të përgjithshme; 7. Kutitë e sigurisë duhet të vendosen në vende të qasshme ku përdoren gjilpërat; 8. Kutitë e sigurisë duhet vendosur shumë afër vendit të administrimit dhe qasja për hedhje të gjilpërave pas përdorimit duhet të jetë e qasshme; 9. Kutinë e sigurisë duhet kontrolluar vazhdimisht se sa është e mbushur, gjithmonë duhet të mbushet vetëm deri në ¾ e saj; dhe pas mbushjes të zëvendësohet me kuti të re – asnjëherë nuk duhet të mbushet e plotë apo të rimbushet; 10. Kutitë e sigurisë nuk duhet zbratur asnjëherë, por hedhen si të tëra, dhe largohen pa manipulime të mëtejshme; 11. Në rast të lëndimit me gjilpërë, menjëherë kontaktoni profesionistin gjegjës në Klinikën Infektive në QKUK, gjegjësisht Repartin infektiv në SP, ose mjekun përgjegjës në institucion shëndetësor privat²; 12. Për sigurinë e personave tjerë, gjilpërat e përdorura asnjëherë nuk duhet lënë në vende ku mund të lëndohen të tjerët; 13. Pas mbushjes së kutisë së sigurisë, kryeinfermierja e njofton higjienistin /en për largimin e kutisë deri në vendin e deponimit.
[II]	Hedhja e Mjeteve Tjera të Mprehta	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të gjitha mjetet e tjera të mprehta (gjilpërat nën lëkurore, bisturitë dhe mjetet tjera me tehe, thika, sete infuzioni, sharra, xhama të thyer dhe pipeta) duhet të hedhen në kuti të sigurisë;

² Institucionet e lartpërmendura duhet të emërojnë personin përgjegjës për rastet e lëndimit me mjete të mprehta!

[III]	Deponimi i Kutive të Sigurisë	<ol style="list-style-type: none"> 2. Kutitë e sigurisë të mbushura duhet të ruhen në dhomë/vend adekuat në hapësira të institucionit, deri në transportin e tyre për asgjësim final, nga ana e higjienistit; 3. Hapësirat e tilla duhet të jenë larg pacientëve, dhe nuk duhet të jenë të qasshme për personat tjerë, të cilët frekuentojnë institucionin; 4. Këto hapësira shfrytëzohen përkohësisht, vetëm derisa të bëhet largimi i mbeturinave në depon qendrore të institucionit shëndetësor;
[IV]	Transporti i Kutive të Sigurisë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Transporti i kutive nga institucioni deri në destinacionin e fundit për asgjësim të tyre, duhet të bëhet me kujdes të shtuar, me qëllim të shmangies së kontaktit me persona të tjerë; 2. Transporti deri në depon qendrore të mbeturinave duhet të bëhet me kontejnerë të mbyllur/karroca të shenjëzuara si ‘mbeturina të rrezikshme’ (kodimi me ngjyrë të verdhë); 3. Kontejnerët dhe mjetet e tjera të transportit duhet të dezinfektohen pas çdo përdorimi; 4. Kutitë e sigurisë vendosen në kontejnerë të mbyllur të verdhë deri në depon qendrore.
[V]	Asgjësimi i Kutive të Sigurisë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Asgjësimi i kutive të sigurisë bëhet në Autoklav ose Incinerator.
SQARIM		<p><i>Mjetet e mprehta</i> janë mjete që mund të shkaktojnë prerje ose plagë të shpuara, duke përfshirë gjilpërat, gjilpërat nënlëkurore, bisturitë dhe mjetet tjera me tehe, thika, sharra, xhama dhe pipeta të thyera. Pavarësisht nëse janë apo nuk janë të infektuara, mjetet e tilla zakonisht konsiderohen mbeturina shumë të rrezikshme të kujdesit shëndetësor dhe duhet të trajtohen sikur të ishin potencialisht të infektuara.</p>

Referenca:

1. *Safe management of wastes from health-care activities Second edition* Edited by Yves Chartier, Jorge Emmanuel, Ute Pieper, Annette Prüss, Philip Rushbrook, Ruth Stringer, William Townend, Susan Wilburn and Raki Zghond, World Health Organization 2014.